



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit, z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, Komisioni Disiplinor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. {...}, gjyqtar.*
- 8. {...}, Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 9. {...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit, z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, Komisioni Disiplinor.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen, në fakt mbledhja e fundit e Këshillit të Lartë Gjyqësor ku në trupën tonë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke filluar nga data 12, do të na largohen 3 kolegë të nderuar. Në fakt është shumë e vështirë për mua që të them që do më ikin tre kolegët, sepse kemi nisur që në ditën një bashkë; mund të kishim të gjithë mendimet e ndryshme, por kemi qenë gjithmonë bashkë. Unë në fakt dëshiroj që t'i falenderoj shumë për përkushtimin që kanë pas të tre kolegët, për sakrificat që kanë bërë, për mbështetjen që i kanë dhënë Këshillit, dhe jo vetëm Këshillit, por të gjithë sistemit gjyqësor. Që të tre

kanë qenë, pa dashur të them emra, kanë qenë një vlerë shumë e madhe për këtë Këshill dhe shpresoj për të gjithë sistemin, me të gjithë vendimmarrjet dhe sugjerimet, propozimet. Dhe nëse kemi bërë ndonjë debat, gjithmonë ka qenë për të mirën e punës dhe ashtu si ka dalë në fakt, ka qenë vetëm për të mirën e sistemit. Kështu që, në emër të kolegëve të tjerë, por edhe në emër të stafit, ju falenderoj shumë, falenderojmë për mbështetjen jo vetëm të Këshillit (të kolegëve) por edhe të stafit, sepse kemi qenë gjithmonë një bashkë këtu. Shpresoj që me të njëjtën frymë të kemi mundësi të jemi edhe me kolegët që do na bashkohen. Po unë mund ta them një rezervë, që ndoshta atë që kam pas me ju nuk do ta gjej dot me të tjerët sepse e kemi nisur që nga dita një bashkë. Ju falenderit për të gjithë suportin dhe mbështetjen që i keni dhënë këtij Këshilli.

Tani, në rendin e ditës, duke qenë se është mbledhja e fundit me këtë trupë, në fakt kemi çështje shumë të rëndësishme që neve kemi dashur që t'i përfshijmë pasi kanë qenë pjesë e produktit të punës së këtyre kolegëve që janë këtu. Por përpara se të kalojmë në çështjet që kemi caktuar, unë do të propozoj, në qoftë se gjej mirëkuptimin tuaj, që të shtojmë edhe dy çështje të tjera: E para është caktimi i seancës dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} dhe çështja e dytë është për pranimin në shërbimin civil të një nga ndihmësit ligjor që i kemi përfunduar procedurën e kualifikimit, znj. {...} (*lapsus mbiemri, është {...}*). Nëse jeni dakord t'i shtojmë këto?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Këto po i shtojmë në fund.

Naureda Llagami: Atëherë, sipas rendit, çështja e parë që kemi është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit, z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

Ftojme magjistratin, gjithashtu ftojme edhe përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Kemi të pranishëm përfaqësuesin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, inspektore {...}. Na ka përcjellë autorizimin nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe letërnjoftimin. Gjithashtu kemi të pranishëm edhe magjistratin z. {...}. Gjithashtu edhe ai na ka përcjellë letërnjoftimin.

Atëherë, siç jeni vënë në dijeni, sot do zhvillohet seanca dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor, i cili është një procedim që ka nisur në fakt që nga Këshilli i mëparshëm (ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë) dhe që është pezulluar. Duke qenë se KLGJ-ja është organi kompetent për heqjen e pezullimit, kemi hequr pezullimin për të dhënë mundësi dhe për të vijuar shqyrtimin e këtij procedimi.

Unë nuk do doja në fakt, se ne jemi vënë në dijeni të të gjithë materialeve, do doja shkurtimisht nga ana juaj që të fillohej me parashtrimin e qëndrimit që ka Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për të kaluar më tej nëse ka parashtrime nga ana e magjistratit.

Ne i administruam në dosje, i morëm të gjithë aktet, kështu që shkurtimisht në gjërat kryesore dhe më pas për të lejuar Këshillin në vendimmarrje. Faleminderit!

{...}: Përshëndetje!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë bazuar në Urdhrin nr. {...}, datë

17.07.2012 të Ministrit të Drejtësisë “Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}” në datën 18.07.2012 ka ushtruar inspektim pranë kësaj gjykate për verifikimin e ankesës së subjektit “{...}” sh.a. Objekt i inspektimit ka qenë verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve procedurale gjyqësore gjatë gjykimit të çështjes civile me palë paditëse “Shoqëria “{...}” sh.p.k; palë e paditur: “{...}” Sh.a. dhe Shoqëria “{...}” sh.p.k; objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbareme të paditur shoqëria private përmbareme “{...}” për procedurat abuzive të ankandit si dhe pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, urdhrin të ekzekutimit nr. {...}, datë 28.05.2010; nr. {...}, datë 01.06.2010; nr. {...}, datë 15.09.2010; nr. {...}, datë 10.09.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} dhe nr. {...}, datë 29.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, pasi detyrimi nuk është në vlerën e pretenduar”.

Kjo padi është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} dhe me short i është caktuar gjyqtarit {...}, i cili pasi ka dëgjuar pretendimet paraprake të palëve ndërgjyqëse, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbareme për ekzekutimin e titujve ekzekutivë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

Ministria e Drejtësisë, duke pretenduar se nga ana e magjistratit {...} janë shkelur rëndë dispozitat procedurale për pezullimin e ekzekutimit të titujve me pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të palëve në proces, me shkresën nr. {...} prot., datë 01.10.2012, ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor për gjyqtarin {...} dhe në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë të vendosë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Gjithashtu, referuar kërkesës për procedim disiplinor të gjyqtarit {...}, me shkresën nr. {...} prot., datë 26.10.2012, të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është parashtruar se, KLD në datën 24.09.2009 ka urdhëruar verifikimin e informacionit të paraqitur nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit {...}.

KLD me shkresën nr. {...} prot, datë 27.09.2012, i ka njoftuar Ministrit të Drejtësisë rezultatet e ushtrimit të inspektimit të zhvilluar me qëllim mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor.

Bazuar në relacionin e përgatitur nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të

Drejtësisë është arritur në përfundimin se magjistrati {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} gjatë periudhës objekt verifikimi nuk ka pasur mungesa pa arsye në detyrë, por vetëm 17 vendime të dorëzuara jashtë afatit.

Në analizë të fakteve të parashtruara, Ministria e Drejtësisë ka çmuar se gjyqtari {...} duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për kryerjen e akteve e sjelljeve që diskreditojnë figurën dhe pozitën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 26.10.2012 Ministri i Drejtësisë bën me dije se në konkluzion të inspektimit të ushtruar në bazë të urdhrit nr. 58, date 08.02.2012 të Ministrit të Drejtësisë "Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}", të ndryshuar, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve procedurale, në çështjet gjyqësore me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, sigurim padie, me shkresën me nr. {...} prot., datë 01.10.2012 i është kërkuar KLD-së nisja e procedimit disiplinor për gjyqtarin {...}, duke i propozuar në bazë të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që të vendosë masën disiplinore "Shkarkim nga detyra", duke propozuar gjithashtu bashkimin e këtij procedimi disiplinor me kërkesën për procedim disiplinor, dërguar KLD-së me shkresën nr. {...}, datë 01.10.2012 dhe caktimin e masës "Shkarkim nga detyra" ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}.

Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor, Ministri i Drejtësisë me kërkesën nr. {...} prot., datë 23.01.2013 si dhe me kërkesën nr. {...} prot, datë 10.07.2013 ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. {...}, datë 14.02.2013, si dhe me Vendimin nr. {...}, datë 19.07.2013, në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", ka vendosur pezullimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

Pas kësaj vendimmarrje nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në datën

19.07.2013 nuk është zhvilluar asnjë procedurë apo nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me këtë procedim disiplinor pavarësisht parashikimeve të nenit 172, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku sanksionohet detyrimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të kryejë brenda 6 muajve procedimet disiplinore të papërfunduara në KLD në momentin e hyrjes në fuqi në datën 22.11.2016 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. {...} prot, datë 30.11.2023, ka vendosur shfuqizimin e vendimeve nr. {...}, datë 14.02.2013 dhe nr. {...}, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykata më të larta si dhe vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} si dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga praktika dokumentare lidhur me kërkesën për procedimin disiplinor nga ana e Ministrit të Drejtësisë në lidhje me magjistratin {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} rezulton se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur në vitin 2009 dhe në vitin 2012.

Në kohën kur shkeljet e pretenduara kanë ndodhur, për shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratët ka qenë në fuqi ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 34, pika 2 parashikonte se: “Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes”.

Në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008, nuk ka dispozitë analoge si ajo e nenit 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i cili në pikën 5 parashikon se: “Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117, i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë”.

Për sa më sipër rezulton se shkeljet e pretenduara për të cilat ka nisur procedimi disiplinor ndaj magjistratit {...} janë parashkruar. Instituti i parashkrimit shuan të drejtën

e organit disiplinor të hetojë dhe të japë vendim për masë disiplinore ndaj magjistratit për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, i cili llogaritet nga momenti i kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar. Respektimi i afatit të parashikuar për kryerjen e procedimeve disiplinore është në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë: Mbylljen e procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore për të cilat ka nisur ky procedim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, ia jap fjalën magjistratit nëse ka diçka për të shtuar.

{...}: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në kushtet e tërheqjes për shkak të parashkrimit unë e kuptoj që proceduralisht ndoshta nuk është vendi për të thënë diçka për themelin e çështjes sepse jam dakord me këtë kërkesë, ama dy minuta do mi lejoni sepse unë kam 12 vjet me një procedim të hapur dhe dua që të paktën në çështjen time të përfshihen parashtrimet e mia sepse unë nuk jam gjyqtar që fshihem pas procedurës. Unë dua që në dosje të jetë qëndrimi im që ky procedim ishte i padrejtë. Nuk kam asnjë përgjegjësi ose shkelje ligjore për të cilat dua të mbaj përgjegjësi.

Edhe një pyetje që e di që është pa përgjigje: Kush ma kthen mbrapsht mua qetësinë e humbur për 10 vjet, qetësinë e familjes time, të prindërve të mi, kohën e munguar familjes dhe djalit tim? Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kolegët nëse kanë ndonjë pyetje mbi çfarë u diskutua.

(Nuk ka pyetje.)

Nëse s'kemi pyetje atëherë unë do ju ftoj, si përfaqësuesen e institucionit të ILD-

së ashtu edhe magjistratin të vazhdojnë, për të lejuar Këshillin në vendimmarrje.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, nga kolegët kemi diskutime? Relatori?

Kemi qëndrim nga ana e Komisionit, duke filluar me relatorin?

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Kryetare!

Për sa kam parashtruar dhe për sa dokumentacionet dhe relacionet ndodhen në dosje, dhe për sa u parashtrua edhe nga përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijimin e kësaj procedure disiplinore, unë si relator jam me këtë qëndrim, që të vazhdojmë me mbylljen e këtij procedimi disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...} në funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore për të cilat ka nisur ky procedim.

Dhe si relator, natyrisht do bëjmë pjesë edhe ato thënie të magjistratit, të cilat i tha publikisht.

Naureda Llagami: Diskutim tjetër?

Nga kolegët e tjerë nëse ka ndonjë diskutim?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Edhe unë ndaj të njëjtin mendim me relatorin, me z. Rusi. Jam dakord edhe me atë që propozon përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke propozuar edhe unë mbylljen e këtij procedimi disiplinor për shkak të parashkrimit.

Ridvan Hado: Edhe unë jam dakord me dy kolegët e tjerë për mbylljen e procedimit sipas propozimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të parashkrimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, lidhur me vendimin, jemi dakord me çfarë propozon Komisioni mbi mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit? Komisioni kanë ardhur të tre me mbylljen e procedimit, pranimin e asaj çka tha përfaqësuesja e ILD-së. Ju të tjerët? Iren?

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, të thërriten palët që t'i komunikojmë vendimin e Këshillit.

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli vendosi unanimisht:

Mbylljen e procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore për të cilat ka nisur ky procedim.

Me kaq, faleminderit!

Mirupafshim!

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 4. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 5. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 6. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”.

Naureda Llagami: Pa humbur kohë kalojmë tek projekt-akti tjetër që kemi në rend dite, i cili në fakt është një akt shumë i rëndësishëm. Është një nga aktet që grupi i punës që është marrë me hartën gjyqësore, ka hartuar. Është një akt i cili i është dashur kohë. Është akt që i është nënshtruar konsultimit të brendshëm dhe të jashtëm në sistemin tonë. Kështu që, shkurtimisht unë do të ftoja zonjën Ukperaj, por gjithashtu për ta plotësuar edhe z. Kelment Greca, mbi prezantimin e këtij projekt-akti, ku synon ky projekt-akt dhe çfarë synon që të rregullojë mbi rindarjen me short të çështjeve gjyqësore.

Zonja Ukperaj, shkurtimisht mbi qëllimin e projekt-aktit.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli tashmë ka miratuar rregullat e ndarjes së çështjeve me short. Projekti i rindarjes është një projekt që ka filluar punën e tij që nga Grupi i Punës për implementimin e hartës gjyqësore, ka vijuar më tej, sikundër edhe ju e relatuat, deri në hartimin e këtij drafti final, pasi janë marrë edhe mendimet e disa prej kryetarëve në detyrë të gjykatave.

Rindarja e çështjeve me short ka për qëllim caktimin e gjyqtarit relator në gjykimin e një çështjeje gjyqësore si kur ai gjykon i vetëm, ashtu edhe kur gjykon në një trup kolegjal. Ndërkohë që rregullat për formimin e mëtejshëm të trupave gjykues do të përcaktohen me akt tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Është projektvendimi i cili është në përpunim e sipër. Ka ardhur një variant për krijimin e seksioneve dhe trupave gjykues.

Dua të theksoj që objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rasteve dhe kritereve për rindarjen e çështjeve me short në të gjitha gjykatat e niveleve të Republikës së Shqipërisë, gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e shkallës së dytë, edhe në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur ligji termin “seksion” e barazon me kolegjin e Gjykatës së Lartë.

Në nenin 3 janë parashikuar parimet, ndër të cilat një parim i rëndësishëm është edhe ai i efijencës e cila sigurohet ndërmjet disa dispozitave të parashikuara në projektvendimin për rindarjen me short të çështjeve. Dua të theksoj që mënyra e rindarjes me short të çështjeve heq praktikën e deritanishme, në disa gjykata, të shortit manual dhe garanton që rindarja me short e çështjeve, duhet të kryhet vetëm nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe i nënshtrohet të njëjtave rregulla që kemi parashikuar për ndarjen me short të çështjeve në aktin e mëparshëm.

Në këtë projektvendim janë parashikuar në disa dispozita më vete, rastet e rindarjes nga kriteret e rindarjes. Rastet e rindarjes përcaktohen konkretisht në nenin 5. Janë disa raste që lidhen me gjyqtarin, të cilat kanë të bëjnë për shkak të mbarimit të statusit, për shkak të dorëheqjes, përjashtimit, për shkak të caktimit të përkohshëm, komandimit, transferimit, ngritjes së në detyrë, etj. Përmenden në pikën 1 dhe disa raste lidhen edhe me gjykatën dhe kryesisht me sigurimin e efijencës së gjykatës, konkretisht për shkak të riorganizimit të brendshëm të gjykatës nëpërmjet krijimit të seksioneve të reja nëpërmjet shtimit ose pakësimit të trupave gjykues në një seksion apo caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër, si dhe garanton edhe mënyrën se si do të bëhet marrja në

short e çështjeve nga gjyqtarët e rinj që shkojnë në një gjykatë.

Nuk i nënshtrohen rindarjes me short të çështjeve vetëm çështjet për të cilat kryetari i gjykatës në fillim të çdo viti duhet të përgatisë kalendarin e shqyrtimit të çështjeve të ngutshme, për të cilat ligji na autorizon të miratojmë një akt të pavarur.

Veç këtyre rasteve të rindarjes, për të mos qenë të kufizuar dhe ezaurues në rastet, kemi parashikuar edhe një mundësi sepse evoluimi i praktikës mund të na përballë me situata të cilat nuk mund të ishin të parashikuara, e tillë që parashikohet në nenin 5, pika 3, ku kryetari i gjykatës në çdo rast tjetër veç këtyre rasteve të parashikuara në vendim, kur vlerëson se zgjidhja e një situatë konkrete që ka të bëjë me efikasitetin e drejtësisë mund të bëhet vetëm përmes rindarjes së çështjeve me short, atëherë ai duhet të informojë menjëherë Këshillin, i cili është ai që vlerëson nëse ajo situatë përbën një rast nevojë që justifikon rindarjen me short të çështjeve, për shkak se rastet duhet të përcaktohet vetëm nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që në nenin 6 dhe nenin 7 përcaktohen kriteret mbi të cilat bëhet rindarja e çështjeve me short. Në nenin 6 janë të parashikuara kriteret që kanë të bëjnë me rrethanat që lidhen me gjyqtarin, pra në rastet kur gjyqtari ndërpret përkohësisht apo në mënyrë të përhershme veprimtarinë e tij si gjyqtar apo veprimtarinë e tij gjyqësore në një gjykatë të caktuar. Ndërkohë që në nenin 7 përcaktohen kriteret për rindarjen e çështjeve me short për rrethana që kanë të bëjnë me gjykatën ku ato janë regjistruar, dhe këtu kryesisht janë rrethana që kanë të bëjnë me sigurimin e efikasitetit të gjykimeve në një gjykatë.

Në pikën 1 është parashikuar që rindarja e çështjeve me short në rastet e deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit ndodh menjëherë nga vërtetimi ose me miratimin e vendimit të mbarimit të statusit nga ana e Këshillit.

Në pikën 2 ka një parashikim më të detajuar për shkak se paaftësia e përkohshme, për shembull, në punë e gjyqtarit mund të jetë shkak për rindarje të çështjeve por jo domosdoshmërisht në të gjitha rastet kjo paaftësi do të çojë në rindarje. Në varësi të rrethanave, është kryetari i gjykatës i cili vlerëson shkakun konkret lidhur me rindarjen e çështjeve, vlerëson shkallën e urgjencës së çështjeve, vlerëson fazën e gjykimit të tyre si dhe kohën ose pritshmëritë për rifillimin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të cilit i janë

caktuar. Bazuar në rrethana të njohura apo në informacionet e marra nga autoritetet përkatëse, kryetari i gjykatës, nëpërmjet një akti të motivuar, mund të urdhërojë rindarjen e të gjitha çështjeve të atij gjyqtari apo të një pjese apo kategorie të caktuar të tyre, si dhe për kohën e rindarjes me short të tyre.

Për sa i përket çështjeve të ndara me short, për të cilat është e nevojshme të bëhet rindarja, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit, si gjyqtar i vetëm, këto çështje rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, ndërsa shkak i rindarjes lind përpara fillimit të gjykimit ose përpara shpalljes së tyre për gjykim, rindahet me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

Ndërsa pika 6 parashikon rastin tjetër kur nevoja për të bërë rindarje dhe shkaqet e rindarjes lindin gjatë kohës së gjykimit të çështjes - në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, dhe shkak i rindarjes lind gjatë gjykimit ose kur çështjet janë shpallur për gjykim në gjykatat e apelit apo Gjykatën e Lartë, rindarja me short për përcaktimin e relatorit bëhet ndërmjet anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, i cili më pas plotësohet me një anëtar tjetër.

Për sa i përket “Kritereve për rindarjen me short të çështjeve për rrethana që kanë të bëjnë me gjykatën”, dhe këto janë kriteret e efikasitetit, është parashikuar që çështjet rindahen me short në varësi të shkakut konkret të rindarjes menjëherë me konfirmimin e tij. Një rast mund të jetë ai i suprimimit të gjykatës dhe ne kemi parashikuar atë gjë që ne bëjmë në rastin e implementimit të hartës gjyqësore, ku nëse gjykata suprimohet, çështjet që gjyqtari i suprimuar, gjyqtari i gjykatës së suprimuar ka pasur për shqyrtim, nuk rindahen me short, por do të vazhdojnë të shqyrtohen prej tij tani si gjyqtar i gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore pas riorganizimit.

Në rastet kur krijohen seksione të reja në gjykatë, çështjet që i përkasin këtyre seksioneve rindahen me short me krijimin e tyre (midis gjyqtarëve të seksionit). Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave nuk ka filluar për gjykatat e

shkallës së parë apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta (për të garantuar të gjitha aspektet e një procesi të rregullt ligjor). Është kryetari i gjykatës autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, si dhe për përcaktimin e çështjeve të regjistruara më parë që do të rishortohen.

Në rastin e shtimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, çështjet e seksionit ku shtohen trupat gjykues rindahen me short me krijimin e trupave të reja gjykuese. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të trupave gjykuese (këtu futen edhe gjyqtarët e rinj që shkojnë në gjykatë), si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e caktuar rishtazi në një seksion të gjykatës, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të këtij seksioni, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme.

Është parashikuar e njëjta gjë edhe në rastin e pakësimit të trupave gjykues. Është bërë i njëjti parashikim edhe në rastin e caktimit të gjyqtarit nga një seksion në një seksion tjetër të gjykatës. Po kështu edhe në rastin e shtimit të gjyqtarëve në një gjykatë.

Parimi që është ndjekur në këto raste është ai që çështjet sipas vjetërsisë së tyre dhe sipas kategorive duhet të rindahen me qëllim që edhe gjyqtarët e rinj që futen në seksionin e gjykatës të kenë një ngarkesë mesatare jo më të lartë se ngarkesa mesatare për gjyqtar në atë seksion.

Së fundmi është parashikuar edhe një dispozitë, e cila ngarkon Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor që të kryejë të gjithë procedurat dhe zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve me qëllim që ky sistem t'i vijë në funksion pikërisht kësaj vendimmarrjeje të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me anë të këtij projekt-akti uniformizohet në një farë mënyre rindajrja e çështjeve, përcaktohen kompetencat e qarta për organin administrativ i cili ka përgjegjësi

kryesore për rindarjen e çështjeve dhe njëkohësisht parashikohen edhe marrëdhëniet që ai krijon me Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në këtë mënyrë do të kemi edhe evadimin e shumë kërkesave që na vijnë nga gjykatat lidhur me situatat ku kërkohet mendim për rindarje ose jo të çështjeve gjyqësore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi diskutim? Duke qenë se akti i është nënshtruar disa herë diskutimeve.

Po zonja Shehu!

Po, atëherë nuk kemi.

Nëse nuk kemi diskutime, unë do sugjeroja në fakt që të vijojmë me miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur, të përmirësuar.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi vendimin mbi rindarjen me short për çështjet gjyqësore.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
4. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”. Ftoj edhe administratën që të bëjë gati hedhjen e shortit. Ia jap fjalën znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Atëherë, projekt-akti i radhës ka të bëjë me fillimin e procedurës së vlerësimit të gradimit për dosjet e ardhura rishtazi nga organet e rivlerësimit sipas nenit 171, pika 5, ne kemi detyrimin e trajtimit me përparësi të tyre.

Aktualisht pranë Këshillit janë hedhur shortet për zhvillimin e procedurave të gradimit për të gjitha dosjet e ardhura nga organet e rivlerësimit. Dy dosjet e fundit të ardhura janë ato për gjyqtarët {...} dhe {...}. Ia paraqesim këtë projektraport mbledhjes plenare në kushtet kur gjyqtarja {...} ka kandiduar për ngritje në detyrë dhe ka edhe një shkak tjetër përparësie për fillimin sa më shpejt të procedurës së gradimit.

Lidhur me zhvillimin e shortit kemi menduar që ky short të zhvillohet vetëm mes dy anëtareve të Komisionit znj. Plaku dhe znj. Rupa, në kushtet kur unë jam në mbarim të mandatit dhe midis dy nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, që janë znj. Gilda Hoxha dhe znj. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, administrata të fillojë procesin për hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...} dhe z. {...}.

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa. *(Pa audio, pasi nuk është ndezur mikrofoni)*

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Gilda Hoxha dhe znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet gjyqtarja znj. {...}. Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. {...}.

Përzgjidhet gjyqtari z. {...}. Relator për zotin {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Naureda Llagami: Faleminderit!

E hedhim në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, [...].

i) Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj.Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj.{...};

ii) Për gjyqtarin z.{...} – Relatore znj.Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj.Gilda Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë pa humbur kohë tek vlerësimet.

Unë kisha një sugjerim për relatoren. Duke qenë se një pjesë e vlerësimeve nuk kanë kundërshtime, shkurtimisht të shkojmë tek gjetjet, duke qenë se jemi vënë në dijeni dhe jemi njohur me përmbajtjen e tyre.

Brikena Ukperaj: Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimin e gjyqtares {...} ka për qëllim vlerësimin e aftësive të gjyqtares në periudhën e vlerësimit 2013-2016. Projektraporti i është njoftuar gjyqtares. Nuk ka ankim dhe kundërshtime nga ana e saj.

Me procedurën dhe përshkrimin e burimeve të vlerësimit jeni njohur.

Lidhur me vlerësimin dhe shkallën e aftësisë për secilin nga treguesit dhe kriteret

e vlerësimit:

Për sa i përket kriterit të parë të “Aftësive profesionale”, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht për “Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, për “Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, për “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit”, për “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit” si dhe për “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”.

Në tërësi, referuar të dhënave që kanë rezultuar nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në secilin nga këta tregues. Vendimet janë të qarta, koncize, të kuptueshme, gjithëpërfshirëse. Ka një analizë të detajuar në aspektin procedural dhe në aspektin material. Ka një interpretim abstrakt të ligjit para zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Arsyetimi është i plotë, i qartë dhe përmbush të gjitha standardet e procesit të rregullt ligjor, duke përdorur edhe jurisprudencën relevante aty ku është vlerësuar e nevojshme.

Për sa i përket “Aftësisë organizative të gjyqtarit”, “Respektimit të afateve ligjore”, nuk kanë rezultuar çështje të shqyrtuara tej afatit, kështu që pikëzimi i gjyqtares për këtë kriter është me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale” janë analizuar të gjitha burimet e vlerësimit dhe është propozuar vlerësimi me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të shqyrtimit të çështjeve” ka rezultuar koha e shqyrtimit vetëm për një kategori por edhe ajo kategori ka tejkaluar 2 muaj e 29 ditë, e cila është e justifikuar për shkak të ngarkesës së gjykatës dhe nga ana tjetër gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e kohës dhe kryerjen e veprimeve procedurale. Është pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve” ka rezultuar 98%. Sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë. Por duke marrë parasysh çështjet e shqyrtuara nga gjyqtarja e cila ka tejkaluar 65% të standardit sasior të punës, është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit gjyqësor”, ka rezultuar “më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për shumicën e kategorive të

çështjeve”. Pikëzimi 15 pikë.

Për sa i përket “Numrit të seancave gjyqësore”, ka rezultuar 7.5 seanca, por ndërkohë gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproductive, 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale” është pikëzuar me 20 pikë.

Ndërkohë rregullshmëria dhe saktësia gjithashtu nuk kanë pasur të dhëna për të afektuar negativisht vlerësimin.

Kështu që edhe për “Aftësitë organizative” pikëzohet me 100 pikë.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit e këtij kriteri.

Ndërkohë që për “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional” është vlerësuar maksimalisht për “Aftësinë e komunikimit”, “Aftësinë e bashkëpunimit”, “Respektimit të konfidencialitetit”, shkallës së bashkëpunimit me kolegët me administratën gjyqësore.

Ka gatishmëri të gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera. Ka të dhëna për pjesëmarrje në aktivitete trajnuese si eksperte apo si pjesëmarrëse.

Ka disponueshmëri të gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për magistratë. Ka të dhëna, gjatë stazhit ka qenë udhëheqëse për kandidatin e vitit të tretë z. {...}, i caktuar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjithashtu ka angazhim në veprimtari ndërinstitucionale. Si anëtare e Këshillit ka marrë pjesë në Komisionin e Posaçëm Parlamentar (e provuar) për Reformën në Drejtësi ku ka kontribuar për hartimin e legjislacionit në lidhje me gjyqësorin. Është pikëzuar me 5 pikë edhe për këtë tregues.

Nuk ka publikime ligjore akademike. Është pikëzuar me 0 pikë.

Përfundimisht për secilin nga kriteret:

Për kriterin e parë "Shkëlqyeshëm", 100.

Për kriterin e dytë “Aftësia organizative”, "Shkëlqyeshëm", 100.

Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, "Shkëlqyeshëm", 100.

Për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, 95 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm është "Shkëlqyeshëm", 395 pikë.

(Hidhet në votim projektvendimi).

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016", me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm", gjithsej me 395 pikë. [...]

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti tjetër që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, për vitin 2022. Për më shumë detaje, znj. Ukperaj. Shkurtimisht, për sa kohë nuk kemi kundërshtime.

Brikena Ukperaj: Atëherë, gjyqtarja {...} është vlerësuar me procedurë të përsheptuar të detyruar për vitin kalendarik 2022, për shkak se ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë.

Në pjesën e parë është shpjeguar procedura. Bashkëngjitur raportit të vlerësimit është raporti analitik i përgatitur nga nëpunësi përgjegjës. Aktet ju janë njoftuar. I janë njoftuar gjyqtares. Nuk ka paraqitur kundërshtime.

Duke qenë se përshkrimi i burimeve të vlerësimit bëhet në raportin analitik, shkurtimisht do të ndalem në propozimet e mia lidhur me secilin nga treguesit e kritereve të vlerësimit.

Për sa i përket “Aftësive profesionale të gjyqtarës”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri është propozuar vlerësim maksimal për shkak se ka spikatur aftësia e saj në identifikimin e qartë dhe të saktë, e të kuptueshëm të fakteve, analizën e integruar të provave e cila i paraprin në çdo rast analizës së ligjit dhe identifikimit të normës dhe normave konkrete të cilat kanë shërbyer për zgjidhjen e çështjes. Vendimet janë të qarta, të kuptueshme, koncize. Kanë strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar dhe një cilësi të lartë të analizës dhe argumentimit logjik. Vërehet shkallë shumë e lartë e kujdesit për identifikimin e marrëdhënies shkak – pasojë në zbatim të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Në tërësi në vendimet e vëzhguara gjyqtarja shoqëron analizën gjithmonë me praktikën gjyqësore. Arsyetimi është i plotë, i qartë dhe merr në përgjigje të gjitha pretendimet dhe kërkesat e palëve në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor. Prandaj është propozuar për të gjithë treguesit e këtij kriteri pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësive organizative”, lidhur me “Respektimin e afateve ligjore”, duke marrë parasysh afatin 87-ditor të cilin ne kemi zbatuar për gjykimin e çështjeve administrative ka rezultuar në fakt që çështjet e shqyrtuara jashtë afatit kanë rezultuar në masën 35%. Duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, objektivitetit përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh të shqyrtohen brenda afateve të caktuara si dhe kushtet e punës dhe numrin relativisht të vogël të çështjeve me afat gjykimi (ka pasur 17 nga 6 të cilat janë jashtë afatit), nuk justifikohet një pikëzim maksimal dhe kam vlerësuar që gjyqtarja duhet të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi. Për këtë arsye është pikëzuar me 12 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, ka rezultuar nga analiza se kanë qenë 28% jashtë standardit 87-ditor. Ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës si dhe ka rezultuar që gjyqtarja, pavarësisht ngarkesës ka përfunduar më shumë se 50% të standardit sasior në fuqi. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi maksimal.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” ka rezultuar e tejkaluar vetëm me 27 dhe 21 ditë për dy kategori çështjesh. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi maksimal me 5 pikë.

“Rendimentit” ka rezultuar në masën 98.8% dhe duke referuar tejkalimit me më shumë se 50% të standardit sasior, është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsytimit të vendimit”, ka rezultuar “më e gjatë se afati procedural por e tejkaluar me vetëm 0.2 ditë për një kategori dhe 1.75 ditë për një kategori tjetër. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi maksimal.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, pikëzimi është maksimal sepse ka rezultuar se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke marrë parasysh që edhe numri mesatar i seancave gjyqësore të zhvilluara ka qenë vetëm 1.6 seanca gjyqësore, çka tregon që gjyqtarja zhvillon me korrektësi të gjitha fazat e procesit në gjykimin administrativ.

Përfundimisht për kriterin e “Aftësive organizative” propozohet pikëzimi me 97 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Pra është vetëm 3 pikë tek “Respektimi i afateve ligjore” për shkak se ka qenë përqindja e tejkalimit të afatit e konsiderueshme referuar numrit të çështjeve për të cilat duhet të respektohet afati ligjor.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” është pikëzuar maksimalisht për të gjithë treguesit e këtij kriteri. Nuk ka pasur të dhëna të cilat mund të afektonin në mënyrë negative treguesit e vlerësimit.

Për sa i përket “Aftësisë personale dhe angazhimin profesional” është vlerësuar maksimalisht për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët dhe administratën gjyqësore.

Lidhur me shkallën e pjesëmarrjes në trajnimin vazhdues. Në cilësinë e ekspertes ka marrë pjesë në dy aktivitete të zhvilluara në dy ditë trajnimi. Në cilësinë e lehtësueses në dy aktivitete në dy ditë trajnimi dhe në cilësinë e pjesëmarrësit në një aktivitet. Ka përmbushur detyrimin ligjor për 10 ditë trajnim dhe ndërkohë që ka trajnime edhe jashtë Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me IRZ dhe me Rrjetin Evropian të trajnimeve. Është pikëzuar maksimalisht.

Për sa i përket disponueshmërisë për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional për trajnimin e gjyqtarëve, ka të dhëna sepse është caktuar si gjyqtarë mentorë për praktikën profesionale të viteve 2021 – 2024 dhe për vitin 2021 – 2022

gjithashtu kanë qenë në mentorim pranë saj disa kandidatë për gjyqtarë.

Gjithashtu ka marrë pjesë në cilësinë e ekspertes dhe lehtësueses në disa trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, për këtë arsye është pikëzuar me 5 pikë, pasi ka pasur të dhëna për disponueshmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë dhe për trajnimin e gjyqtarëve.

Për sa i përket pjesëmarrjes në veprimtari ndërinstitucionale është pikëzuar gjithashtu me 5 pikë, për shkak sepse në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës gjyqtarja është miratuar në listën e pedagogëve të kësaj shkolle, pedagoge në dispozicion në lëndën “E së drejtës tregtare” por nuk ka pasur të dhëna efektive në sa ditë e ka ushtruar këtë funksion. Nga ana tjetër është angazhuar si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2022-2023 në lëndën “Etika profesionale në drejtësinë penale”. Për këtë angazhim ka njoftuar edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Gjithashtu ka qenë e angazhuar në rolin e ekspertes në Udhëzuesin për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve, i financuar nga OSCE. Ka marrë pjesë në një “workshop” “Adjudication of environmental issues” që është zhvilluar nga “CEELI Institute”. Duke marrë parasysh që ka të dhëna lidhur me veprimtarinë ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, është pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket publikimeve ligjore akademike, referuar burimeve të vlerësimit, ka rezultuar se në muajin qershor të vitit 2022 ka mbrojtur temën e doktoraturës me disertacionin “Përgjegjësia penale e personave juridikë në veprat penale në fushën e mjedisit”, për të cilën është vlerësuar me 98 pikë për dhënien e gradës shkencore, me vendimin e jurisë nr. 282, datë 30.06.2022. Duke marrë parasysh edhe këtë disertacionin e gjyqtarës në mbrojtjen e gradës “Doktor”, në vlerësimin tim ai përbën kërkim shkencor dhe kontribut në avancimin e njohurive shkencore i barasvlershëm me botimin shkencor (madje me disa artikuj shkencor së bashku) dhe duke vlerësuar që në zbatim të nenit 77, shkronja /gj/ dhe nenit 82, pika 2 e ligjit “Për statusin” ai është tregues i ngritjes profesionale të gjyqtarit. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, tipologjisë dhe impaktit të kërkimit shkencor, çka ka sjellë përfshirjen e lëndës “E drejta e mjedisit” në kurikulën e re të Shkollës së Magjistraturës (disertacioni është bërë për “Përgjegjësinë penale të personave juridikë në të drejtën e mjedisit”), kam vlerësuar që duhet të pikëzohet edhe

për publikimet ligjore akademike me 5 pikë.

Përfundimisht për të gjithë kriterin e katërt pikëzimi është 100 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është 100 pikë “Aftësitë profesionale”, 97 pikë “Aftësitë organizative”, 100 pikë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe 100 pikë “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”. Përfundimisht pikëzimi 397 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, unë do propozoja kalimin në votim të projektraportit, për sa kohë s’kemi dhe kundërshtime.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, për vitin 2022, me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm", gjithsej me 397 pikë.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti i radhës që ka të bëjë me raportin për gjyqtarin {...}. Edhe për këtë sërish fjalën ia japim zonjës Ukperaj e cila shkurtimisht, pasi edhe në rastin e magjistratit {...} nuk kemi kundërshtime, shkurtimisht gjetjet e raportit.

Brikena Ukperaj: Atëherë, gjyqtari {...} është vlerësuar me procedurë të përsheptuar për shkak të ngritjes në detyrë, për vitin kalendarik 2019. Është njoftuar për projektraportin e vlerësimit. Nuk ka paraqitur kundërshtime.

Përshkrimi i burimeve të vlerësimit është bërë në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” është pikëzuar maksimalisht për “Aspektin e njohurive ligjore” spikat aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë

të fakteve të çështjes, për trajtimin e kërkesave të palëve, për faktet thelbësore të paraqitur prej tyre, të cilat janë paraqitur në mënyrë të detajuar, të plotë, analitike, të integruara me provat e administruara.

Ka aftësi shumë të lartë identifikimi dhe interpretimi i normës procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore të çështjes.

Është pikëzuar maksimalisht për njohuritë ligjore, për aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, për qartësinë dhe kuptueshmërinë dhe koncizitetin e vendimit, strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar si dhe për cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik. Të gjitha pretendimet e palëve të shtruar në diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor gjejnë përgjigje në vendimin e gjyqtarit në gjuhën juridike të duhur për analizimin e tyre, në shërbim të zgjidhjes së çështjes, dhe për këtë arsye pikëzohet me 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket "Aftësive organizative", për "Respektimin e afateve ligjore", propozimi për pikëzim është me 12 pikë. Ka pasur 33 çështje me afat ligjor për të shqyrtuar, nga të cilat 14 çështje janë tejkaluara në shqyrtimin e tyre për sa i përket afatit ligjor me një mesatare tejkalimi 39 ditë për çështjet me objekt "Kundërshtim veprimesh përmbarimore". Fakti që në 5 çështje në kohën e shqyrtimit të tyre ka qenë më e vogël se 45 ditë, brenda të cilës mund të përfundojë gjykimi i së njëjtës çështje në gjykatën e apelit. Tejkalimi i afatit ligjor për 6 çështjet me objekt "Sigurim padie" është bërë vetëm me disa ditë, dhe për këtë arsye, pavarësisht se ka dalë një përqindje në 42% e çështjeve jashtë afatit ligjor, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që kategori të caktuara çështjesh të shqyrtohen brenda afatit duke marrë parasysh që kanë qenë 33 çështje, 14 nga të cilat jashtë afatit, kam propozuar pikëzimin me 14 pikë.

Për sa i përket "Plotësimi të standardeve minimale kohore", pikëzimi është me 5 pikë. Rezulton i tejkaluara në masën 17%, ndërkohë që ngarkesa sasiore dhe treguesit e punës së gjyqtarit kanë reflektuar që ka përfunduar 576 çështje, nga të cilat 158 çështje

me palë kundërshtare.

Për “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” pikëzimi është me 4 pikë se ka rezultuar e tejkaluar për disa nga kategoritë e çështjeve duke u tejkaluar me 51 dhe 56 ditë; si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat kjo kohë rezulton e tejkaluar dhe natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve, bazuar në analizën logjike dhe statistikore, pikëzimi është bërë me 4 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve” ka qenë në masën 89% por ndërkohë ka rezultuar se gjyqtari ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit me 32% dhe për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 8 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar”, është pikëzuar me 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave” dhe “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e tyre” është pikëzuar maksimalisht me 15 dhe 20 pikë. Po kështu edhe aftësia e gjyqtarit për rregullshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes.

Pikëzimi total për kriterin e “Aftësive organizative” propozohet 94 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit e kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

Ndërkohë, për sa i përket kriterit të katërt është vlerësuar maksimalisht për aftësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit.

Ka pasur të dhëna për pjesëmarrje në programin e formimit vazhdues dhe në trajnime të tjera profesionale.

Gjithashtu ka pasur të dhëna edhe për mentorim. Është caktuar si gjyqtar mentor për kandidatët për vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës.

Nuk ka të dhëna për pjesëmarrje në veprimtari ndërinstitucionale dhe publikime ligjore akademike.

Për këtë arsye, për kriterin e katërt, pikëzimi 93 pikë.

Përfundimisht për katër kriteret propozimi për nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit është si më poshtë:

“Aftësia profesionale”, 100 "Shkëlqyeshëm", “Aftësitë organizative”, 94

"Shkëlqyeshëm", "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale" 100 "Shkëlqyeshëm" dhe "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" 93 pikë, "Shkëlqyeshëm". Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 387.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të relatores.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Nuk dëgjohet.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Irena Plaku: Pro edhe një herë.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, për vitin 2019, duke e vlerësuar në nivelin e përgjithshëm "Shkëlqyeshëm", me 387 pikë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
- 4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti i radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional për gjyqtarin {...}. Për më shumë detaje prapë fjalën relatores e cila shkurtimisht do të na prezantojë gjetjet. Por në rastin konkret kemi edhe kundërshtime.

Brikena Ukperaj: Gjyqtari {...} është vlerësuar me procedurë të përshpejtuar për vitin kalendarik 2021, pasi është gjyqtar në procedurën e ngritjes në detyrë. Gjyqtari është njoftuar për projektraportin e vlerësimit. Ka paraqitur kundërshtime dhe një provë shtesë të cilat unë do t’i relatojë në atë moment kur do të diskutohet propozimi im për nivelin e vlerësimit dhe për pikëzimin e atij kriteri.

Bashkëngjitur këtij projektraporti gjeni edhe raportin analitik në të cilin është bërë përshkrimi i të gjitha burimeve të vlerësimit.

Për sa i përket kriterit të parë të “Aftësive profesionale”, në drejtim të “Aftësisë

për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, ka rezultuar aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për identifikimin e qartë dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve, identifikimit të normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes. Pikëzimi 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin” kanë rezultuar aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur ka qenë e nevojshme, ka identifikuar praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor, kryesisht në çështjet penale, pasi gjyqtari ka qenë gjyqtar i seksionit penal. Ka gjykuar shumë çështje penale, por në vitin 2021, për shkak të karakteristikave të gjykatës ku ka pasur vetëm 6 gjyqtarë, ka gjykuar edhe një numër të caktuar të çështjeve civile.

Për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, pas analizës së të dhënave nga burimet e vlerësimit kam propozuar pikëzimin me 15 pikë, aftësia është shumë e lartë, pasi në tërësi ka rezultuar aftësi e lartë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të këtij treguesi. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

Për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të organizuar” pikëzimi është me 10 pikë, shumë e lartë. Struktura ka një metodologji të unifikuar edhe pse jo në aspektin vizual por gjithmonë është e dallueshme në kuadër të rrjedhjes logjike të argumentimit.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik” propozohet shkallë shumë e lartë e aftësisë, pikëzimi me 25 pikë. Gjyqtari e ka zhvilluar argumentimin e tij duke ndjekur logjikën e zhvillimit të marrëdhënies shkak-pasojë si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t’i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve. Pikëzimi 25 pikë.

Përfundimisht për kriterin e parë të “Aftësive profesionale” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive organizative”, “Respektimit të afateve ligjore”, janë analizuar të gjitha çështjet dhe ka rezultuar se nga 59 çështje të cilat kanë pasur të parashikuara afat ligjor për përfundimin e tyre, duke zbritur çështjet, lejet e papaguara, lejen vjetore, tejkallimet e papërfillshme, kanë rezultuar të përfunduara jashtë afatit 36 çështje ose 17% që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila pikëzohet me 12 pikë. Duke marrë parasysh përqindjen, ngarkesën e gjyqtarit si relator, i cili ka gjykuar në total 351 çështje dhe si anëtar 339 çështje; ngarkesën e shtuar për shkak të caktimit të tij për të gjykuar në gjykata të tjera, në total për 17 çështje (15 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë dhe 2 çështje në Gjykatën e Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar); vetëvlerësimin e gjyqtarit për shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatje; numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator pasi rezulton se ka përfunduar 209 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 60% të çështjeve të shqyrtuara prej tij në vitin 2021; kam vlerësuar që gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi seç rezulton nga përqindja matematikore dhe të pikëzohet me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore” është bërë analiza. Ka rezultuar vetëm 7% e çështjeve në tejkallim të standardit minimal, që sipas metodologjisë pikëzohet me 5 pikë.

Për “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” ka rezultuar se kjo kohë mesatare është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 5 nga 7 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare më e gjatë se standardi për dy nga kategoritë që janë “seancat paraprake” dhe “kërkesat penale të fazës së ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, rezulton i tejkalluar me 34 dhe 42 ditë. Duke vlerësuar kategorinë e çështjeve ky konsiderohet i papërfillshëm dhe bazuar dhe në natyrën jo detyruese dhe orientuese, konsiderohet në kuadër të ngarkesës së gjyqtarit si i tillë dhe për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, këtu ka një specifikë për gjykatën e apelit Tiranë për shkak të numrit të lartë të çështjeve gjyqësore gjatë vitit 2021, ku gjykata e apelit ka qenë vetëm me 6 gjyqtarë. Referuar raportit analitik ka rezultuar se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të

përfunduara si relator (351), me numrin e çështjeve të caktuara (832, pa përfshirë çështjet e caktuara nga rishortimi) ka rezultuar rreth 42.18%, përqindje e cila sipas metodologjisë, pikëzohet me 2 pikë (pra vetëm me analizë matematikore do shkojmë me 2 pikë).

Nga ana tjetër gjyqtari ka shpjeguar se shtimi i numrit të çështjeve të shortuara të pagjykuara nuk lidhet me pakësimin e gjykimeve nga ana e tij, por me uljen e numrit të gjyqtarëve të cilët shortohen çështjet.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo treguesin sasior. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret me 150 çështje penale.

Lidhur me rritjen e papritur të volumit të çështjeve evidentohet se gjatë vitit 2021, janë larguar nga detyra katër gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarit subjekt vlerësimi me 1669 çështje, çka ka rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e punës së gjyqtarit, ku vetëm gjatë muajve korrik-shtator 2021 i janë caktuar 1535 çështje, pa përfshiri këtu çështje e caktuar me short.

Ndërkohë lidhur me treguesin sasior të punës ka rezultuar se, gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 351 çështje si relator, nga të cilat rreth 161 çështje penale dhe civile, duke tejkaluar në këtë mënyrë standardin minimal me 11 çështje, ose 7.3%.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, veçanërisht:

(i) të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 351 çështje si relator, nga të cilat 161 penale dhe civile me palë kundërshtare, duke tejkaluar standardin me 7.3 % vetëm për çështjet me palë kundërshtare;

(ii) ngarkesën e tij si anëtar;

(iii) numrin e çështjeve të caktuara në gjykata të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin;

(iv) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak rishortimi kryesisht në 6 mujorin e dytë të vitit (të periudhës së vlerësimit), me rreth 66.7 % të totalit; kam vlerësuar që rendimenti i përfundimit të çështjeve, pavarësisht se rezulton 42.18%, referuar metodologjisë së pikëzimit, për shkaqet që kanë ndikuar në të, lidhen me rritjen e papritur të numrit të çështjeve për shkak të pakësimit të gjyqtarëve, ngarkesës së punës, rritjes së numrit të çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë dhe atyre të caktuara në gjykata të tjera, si dhe shkallën e lartë të angazhimit në trupa të tjerë gjykues për shkak të reduktimit të numrit të gjyqtarëve, ngarkesë e cila nuk e ka penguar gjyqtarin të tejkalojë standardin sasior në fuqi. Por ky tejkallim nuk ka rezultuar mbi 50% për të justifikuar pikëzimin maksimal, pasi janë konstatuar 190 çështje të shqyrtuara si kërkesa penale dhe është propozuar pikëzimi me 8 pikë.

Ndërkohë, lidhur me këtë propozim, gjyqtari ka bërë kundërshtimet e tij, duke parashtruar se (citoj kundërshtimet e gjyqtarit):

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve është llogaritur si raport midis çështjeve të përfunduara me ato të caktuara gjatë një viti kalendarik. Por situata në Gjykatën e Apelit Tiranë në vitin 2021 ka qenë e jashtëzakonshme. Gjatë këtij viti në këtë gjykatë kanë ushtruar detyrën vetëm 6 gjyqtarë. Për këtë shkak të gjitha çështjet e reja civile e penale janë ndarë në short vetëm midis këtyre gjyqtarëve, pa përfshirë këtu çështjet që janë rishortuar disa herë për shkak të largimit të gjyqtarëve. Referuar nenit 74 të ligjit “Për statusin”, për të matur aftësinë për të përballur ngarkesën në punë, vlerësuesi bazohet ndër të tjerash edhe në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore. Por përsëri sipas kësaj dispozite, vlerësuesi duhet të shmangë rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit. Këto rrethana po i parashtrorj në mënyrë të përmbledhur:

1) Gjyqtari nuk mund të kontrollojë numrin e çështjeve që regjistrohen në gjykatë, aq më tepër në një gjykatë apeli ku nga 31 gjyqtarë kanë mbetur vetëm 6 gjyqtarë. Kjo shifër ndikon në llogaritje matematikore sepse zvogëlon rendimentin pavarësisht numrit të çështjeve që evadon gjyqtari.

2) Përgjatë vitit 2021 kam gjykuar 351 çështje si relator dhe 339 çështje si anëtar, pa përfshirë këtu çështjet që janë deleguar në gjykata të tjera. Ngarkesa ime totale e punës

ka qenë 690 çështje të gjykuara (për një vit kalendarik) pasi angazhimi në trupa të tjerë gjykues është gjithashtu kohë pune dhe edhe pse nuk merret parasysh në rendiment, duhet të konsiderohet në pikëzim, si një rrethanë që nuk varet nga magjistrati sepse koha efektive e punës si relator shkurtohet nga angazhimi në trupa të tjerë gjykues.

3) Viti 2021 ka një specifikë tjetër. Për shkak të numrit të mbetur të gjyqtarëve në gjykatë, çështjet me afat ligjor shqyrtimi, kryesisht masat e sigurimit janë gjykuar sipas gatishmërisë vetëm nga 6 gjyqtarë. Këto çështje ashtu sikundër edhe ato penale me afat paraburgimi apo kërkesa për ekstradim, kanë pasur përparësi shqyrtimi. Nga tabela statistikore rezulton se për vitin 2021 kam gjykuar 189 kërkesa penale, të cilat përbëjnë ngarkesë të shtuar për gjyqtarin e apelit dhe që sigurisht ndikojnë edhe në numrin e çështjeve me pale kundërshtare të nxjerra në gjykim.

4) Delegimi në gjykata të tjera zvogëlon kohën efektive në punë në Gjykatën e Apelit Tiranë, rrethanë kjo që nuk është në përgjegjësi e gjyqtarit, e që ka ndikuar në numrin e çështjeve që janë gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

5) Rritja e papritur e numrit të çështjeve dhe kushtet e mësipërme të punës, në një gjykatë apeli me vetëm 6 gjyqtarë, e cila çështjet e themelit i shqyrton me 3 gjyqtarë, ka ndikuar dukshëm në treguesin e rendimentit. Kështu për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor më janë caktuar vetëm nga shorti i çështjeve të reja, 369 çështje, të cilat kam qenë në pamundësi objektive për t'i përfunduar, ndërkohë që nga rishortimi për gjithë vitin 2021 kam marrë 1669 çështje, ngarkesë që edhe pse nuk më është llogaritur në rendiment, ka ndikuar në numrin e çështjeve të zgjidhura. Nëse në rillogaritjen e rendimentit do të zbriten nga numri i çështjeve të caktuara 369 çështje të marra në këto tre muajt e fundit, atëherë rendimenti do të dilte më i lartë.

6) Në këtë situatë jo të zakonitë pune, planifikimi i seancave gjyqësore dhe i dhomave të këshillimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk ishte më përgjegjësi e ekskluzive e gjyqtarit relator, por ajo ishte e lidhur ngushtësisht me mundësinë e anëtarëve të tjerë të trupës gjyqësore për t'u angazhuar në planifikimet dhe gjykimet e çështjeve.”.

Sa më sipër, ka kërkuar që për këtë tregues të ndryshohet pikëzimi nga 8 në 10 pikë. Ka paraqitur edhe një vërtetim të datës 5.12.2023 të Gjykatës së Apelit të

juridiksionit të Përgjithshëm, ku parashikohet se gjyqtari {...}, për vitin 2021 ka pasur një ngarkesë prej 3731 çështje në total (civile dhe penale), nga të cilat 1230 çështje gjyqësore kanë qenë të mbaruara, 369 çështje të rëna në short vetëm për 01.10.2021-31.12.2021, ndërkohë që çështje të rishortuara që i kanë rënë në short për vitin 2021 kanë qenë 1669 çështje.

Në cilësinë e relatores, pasi njihem me kundërshtimet e gjyqtarit, vlerësoj se të gjitha rrethanat që gjyqtari ka parashtruar janë rrethana që qëndrojnë dhe objektivisht të ditura edhe për Këshillin për sa i përket situatës në gjykatën e apelit, për pamundësinë reale dhe objektive të gjyqtarëve për të nxjerrë dhe për të gjykuar tej standardit minimal. Dua të theksoj që gjyqtari në këtë rast e ka arritur standardin minimal për çështjet me palë kundërshtare por nuk e ka pasur të tejkalar me 50% për të shkuar në pikëzim maksimal. Unë në fakt e kam rritur deri në kufirin maksimal të pikëzimit.

Pasi dëgjoj kundërshtimet e gjyqtarit dhe për pamundësinë për të nxjerrë çështjet me palë kundërshtare, vlerësoj që shqyrtimi i kërkesave të masave të sigurimit ka qenë në një masë të konsiderueshme (ka pasur 200) dhe nga ana tjetër angazhimi edhe në trupa të tjerë gjykues; fakti që në vitin 2021 ndryshimet ligjore nuk prekën të gjithë vitin 2021 për të gjykuar masat e sigurimit vetëm me një gjyqtar, por shumicën e kohës janë gjykuar me tre gjyqtarë; kështu që ky 50% në qoftë se shikohet në numrin total të çështjeve të përfunduara (pra dhe me palë kundërshtare dhe pa palë kundërshtare) që është rreth 351 çështje (duhet të ishte 150), pra në qoftë se llogaritet numri total të çështjeve të gjykuara, është e tejkalar në masën 100%. Prandaj në këtë rast propozoj që pikëzimi të jetë maksimal me 10 pikë.

Për sa i përket “kohës mesatare të arsytimit të vendimit gjyqësor”, është bërë analiza dhe është parashikuar e gjitha në projektraport, ka dalë, pas aplikimit edhe të afatit 60-ditor për çështjet penale (duke mbajtur parasysh qëndrimin që mbajtem tek zonja {...}) ka rezultuar më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve, fakt i cili sipas metodologjisë pikëzohet me 6 pikë. Por sipas metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspektet të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar

një koeficient jo më shumë se 20%. Në rastin konkret, duke konsideruar të dhënat që kanë rezultuar nga burimet e vlerësimit lidhur me ngarkesën e lartë në punë, në cilësinë e relatorit dhe anëtarit, angazhimit të tij për gjykimin e çështjeve në gjykata të tjera të ndryshme nga ku ai ushtron funksionin; angazhimin në kohë në procesin e rivlerësimit kalimtar pasi gjatë kësaj kohe gjyqtari ka qenë edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit (e cila sapo u relatua), unë kam propozuar rritjen vetëm me një nivel të vlerësimit, pra nga 6 në 9 pikë. Nga ana tjetër gjyqtari ka paraqitur kundërshtime duke parashtruar lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar se:

“Gjatë vitit 2021 jam përpjekur maksimalisht që vendimet gjyqësore t’i arsyetoj në kohë. Datat e vendosura në statistika (tabelat statistikore) nuk pasqyrojnë datat efektive të dorëzimit prej meje të vendimit të arsyetuar. Vendimet janë arsyetuar në kohë dhe janë dorëzuar tek sekretarja, e cila ka kryer procedurën e marrjes së firmave prej kolegëve, si dhe për dorëzimin e dosjes në sekretari. Kjo kohë ka ndikuar dukshëm në të dhënat statistikore. Edhe zëvendëskryetarja e gjykatës e ka vlerësuar aftësinë time lidhur me këtë tregues shumë të lartë. Prandaj edhe për këtë tregues kërkoj të vlerësohem maksimalisht.”.

Në fakt kryetarja e gjykatës në formularin e vetëvlerësimit të gjyqtarit e ka vlerësuar shumë të lartë aftësinë e gjyqtarit në drejtim të kohës së arsyetimit të vendimeve.

Bashkëngjitur ka paraqitur edhe një vërtetim të lëshuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (kancelarja e gjykatës) ku arsyetohet se vendimet janë arsyetuar në kohë nga ana e gjyqtarit, janë dorëzuar tek sekretarja gjyqësore e cila ka kryer procedurën e marrjes së firmave prej anëtarëve të trupës gjyqësore si dhe procedurat e dorëzimit të dosjeve në sekretari. Këto procedura kanë zgjatur për shkak të ngarkesës së sekretares.

Tani ne nuk kemi të dhëna statistikore për sa i përket kohës efektive se kur është arsyetuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet në tabelat tona statistikore ne marrim si kohë të arsyetimit kohën e dorëzimit të dosjes në sekretari. Nuk janë ngritur pretendime më parë që është arsyetuar dhe nuk është dorëzuar ose edhe gjyqtarët kur kanë paraqitur,

kanë paraqitur bllok shënimesh. Megjithatë, duke marrë parasysh situatën në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe ngarkesën e punës, disa nga këto pretendimet, duke qenë se janë lëshuar me një dokument zyrtar, i konsideroj të besueshme dhe në këtë rast do të propozoj pikëzimin vetëm me një nivel, duke e shtuar në 12 pikë, por jo pikëzim maksimal.

Për sa i përket “Aftësisë për të kryer procedurat gjyqësore”, numrin e seancave dhe shkallën e shmangies së seancave joproductive, kanë rezultuar 3.5 seanca dhe në kushtet kur gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësisë dhe plotësisë së tij”, pikëzimi maksimal, pikërisht me 5 dhe 10 pikë.

Përfundimisht, për sa i përket propozimit për nivelin e vlerësimit të kriterit të “Aftësive organizative”, pasi kam marrë parasysh edhe kundërshtimet e gjyqtarit dhe provën e paraqitur prej tij, propozimi im është për 97 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale” është vlerësuar maksimalisht për të gjithë treguesit e këtij kriteri. Nuk ka pasur të dhëna negative të cilat mund ta afektonin aftësinë e gjyqtarit. Ka pasur vetëm një kërkesë për përjashtim e cila është rrëzuar. Përfundimisht për të gjithë treguesit e këtij kriteri pikëzimi është maksimal dhe në total për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozimi është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive personale dhe angazhimit profesional” është pikëzimi maksimal për “Aftësitë e komunikimit”, “Aftësinë e bashkëpunimit”, Shkallën e bashkëpunimit me kolegët dhe me gjyqtarët. Ka pasur të dhëna nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në trajnimin vazhdues. Ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit sipas shkresës së dërguar nga shkolla në 6 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 6 ditë trajnimi, duke përmbushur kështu nivelin minimal prej 5 ditësh në vit. Është

pikëzuar me 20 pikë për pjesëmarrjen e tij në programin e formimit vazhdues.

Për sa i përket “Disponueshmërisë për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë”, nuk ka pasur të dhëna, 3 pikë.

Edhe për “Veprimtari ndërinstytucionale”, nuk ka pasur të dhëna. Edhe për botimet nuk ka pasur të dhëna.

Për kriterin e katërt 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Përfundimisht për të katërt kriteret propozimi për pikëzim është:

Aftësitë profesionale, 100, "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative, 97, "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100, "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm 388 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim duke qenë se vetë relatorja i pranoi kundërshtimet me sugjerimet përkatëse sikurse e tha? Në tërësi 388, duke rritur 2 pikë tek rendimenti dhe 3 pikë tek pjesa e kohës mesatare të arsyetimit të vendimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Unë jam dakord në fakt për propozimin e zonjës Ukperaj përveç propozimit të “Koha e arsyetimit të vendimit” nga 9 në 12 pikë, për shkak se të njëjtin qëndrim unë kam mbajtur edhe për gjyqtarët e tjerë dhe për sa kohë që unë nuk e kam bërë rritjen e nivelit, i qëndroj të njëjtit qëndrim. Për sa më sipër unë i qëndroj pikëzimit me 9 pikë për sa i përket “kohës mesatare” dhe jo 12. Faleminderit! Për të tjerat jam dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimet.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi raportin e vlerësimit për magjistratin z. {...} për vitin 2021. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Ndërkohë që niveli total i pikëve 388.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator Klodian Kurushi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.

4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator Klodian Kurushi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do e relatojë z. Kurushi?

Klodian Kurushi: Po!

Faleminderit znj. Kryetare!

Shkurtimisht. Është faza e dytë e procesit të aplikimit për t’u komanduar në Gjykatën Kushtetuese. Unë po e relatoj shumë shkurt pjesën e dytë. Pra pasi kemi shpallur kërkesat për të komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën Kushtetuese me vendimin e datës 17.07.2023, është paraqitur një kërkesë nga një kandidat magjistrat,

gjqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës i cili ka shfaqur interes për t'u përfshirë në procedurën e komandimit. Më tej ne kemi bërë verifikimet për kandidatin përkatës referuar nenit 54 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nga ku ka rezultuar se:

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit na rezulton që kandidimi i tij nuk bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; kandidati nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar; nuk ka qenë i komanduar më përpara; nuk ka shërbyer më parë në jo më pak se pesë vjet në skemën e komandimit; si dhe kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Më tej, në lidhje me gjyqtarin kandidat, ne kemi verifikuar edhe rastet dhe rrethanat që i referohen situatës së cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës (Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës), nga ku ka rezultuar që kandidati gjithsej ka gjykuar 177 çështje dhe ka në shqyrtim 182 çështje. Kemi marrë edhe opinionin e zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ku nëpërmjet këtij opinionin ajo nuk ka shfaqur një mendim, po themi, jo favorizues për procesin e kandidimit dhe të vijimit të veprimtarisë së gjyqtarit për t'u përfshirë në procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat në Gjykatën Kushtetuese.

Ndodhur në këto kushte, duke vlerësuar në tërësi se të gjitha situatat e verifikuara nga ana jonë kanë qenë të tilla që nuk pengojnë procesin e vijimit të procedurave për t'u komanduar në Gjykatën Kushtetuese për gjyqtarin z. {...}, në shfaqim mendimin pozitiv (propozojmë) që t'i dërgojmë Gjykatës Kushtetuese emrin e z. {...} i cili ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Kushtetuese si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tij për t'u vlerësuar më tej nga Gjykata Kushtetuese nëse është rasti apo jo i pranimin të tij në procedurat e komandimit.

Me pak fjalë ky ishte relacioni dhe bashkëlidhur relacionit ne kemi paraqitur edhe projektvendimin përkatës i cili është i ndarë në 2 pika. Pika e parë është t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese emri i kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar ndihmësmagjistrat në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe publikimi i

këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit “Mbi dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës Kushtetuese”.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T’i dërgohet Gjykatës Kushtetuese emri i zotit {...}, i cili ka aplikuar për t’u komanduar, “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tij.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.4 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.5 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.6 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.7 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në

orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
4. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit

të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.4 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.5 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.6 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

9.7 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për fillimin e procedurës së transferimeve për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatat ku janë caktuar në mënyrë të përhershme. Për më shumë detaje fjalën do t'ia japim relatorit.

Një sekond Alban, se e do Irena.

Po, Irena!

Irena Plaku: Në fakt unë nuk kam mundur t'i lexoj të gjitha aktet, relacionin, por edhe aktet shtesë, sepse vlerësoj se duhet të njihem edhe me aktet e tjera shtesë, për sa kohë që në fakt ditën e hënë nga pas mbledhjes jam larguar për shkak të një konference rajonale dhe nuk kam qenë në Shqipëri, kam ardhur vetëm dje mbasdite vonë, dhe nuk kam pas mundësi të lexoj për shkak se kemi pasur edhe shumë materiale të tjera. Kështu që unë do kërkoja që të njihem dhe të shtyhet seanca e sotme. Po, sepse unë nuk e kam lexuar, kështu që.

S'e di që është shtyrë ndonjëherë. Unë nuk jam njohur me aktet, kështu që nuk mendoj se mund të jap një vendim sot.

Naureda Llagami: Sipas praktikës që ka Këshilli, kjo çështje shtyhet në një mbledhje tjetër.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Relacion “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”/ "Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin këshilltar juridik në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut."

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.

4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Relacion “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”/ "Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin këshilltar juridik në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut."

Naureda Llagami: Viojmë me çështjen e radhës që ka të bëjë me shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit për gjyqtarin z. {...} në pozicionin këshilltar juridik në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Atëherë, për më shumë detaje, kush do e lexoj relacionin?

Klodi?

Klodian Kurushi: Po e lexoj unë relacionin.

Faleminderit!

Atëherë, po bëj një përmbledhje të shkurtër të relacionit të cilin ne në këtë rast e

kemi paraqitur në dy versione për shkak të veçantisë që paraqet kjo situatë që unë do ta prezantoj tani përpara jush. Kështu që ne kemi bërë bashkëngjitur dy projektvendimeve edhe dy versione të relacionit.

Situata rrjedh fillimisht nga një kërkesë e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Evropës. Kërkesa është përcjellë pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Strasburg, duke përfshirë një draft amendimi në memorandumin e mirëkuptimit për zgjatjen e afatit të sekondimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, aktualisht.

Zoti {...} vijon të punojë si sekondar pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut bazuar në memorandumin e mirëkuptimit nënshkruar në dhjetor të vitit 2023.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, kërkesën e saj ia ka përcjellë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ajo ka kërkuar nëpërmjet kësaj kërkesë zgjatjen e afatit të sekondimit nga autoritetet shqiptare deri në datë 31 dhjetor 2024 (pra afërsisht 1 vit), për shkak të ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe punës së mirë që ka bërë deri tani z. {...}. Me paraqitjen e kësaj kërkesë, pasi kemi verifikuar të gjitha rrethanat, kemi përgatitur relacionet e përmendura më lart.

Referuar kuadrit tonë ligjor, nenit 53, 54 të ligjit “Për statusin”, fillimisht kemi menduar që kërkesa duhet të trajtohet në kuadër të çështjeve që kanë të bëjnë me komandimin e gjyqtarit në institucione ndërkombëtare, pra si çështje që është parashikuar në nenin 53 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por veçantia e trajtimit të kësaj çështjeje lidhet me faktin se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe më konkretisht autoriteti që ka dërguar shkresën që është Sekretariati i Këshillit të Evropës, e ka përcaktuar z. {...} si kandidatin e dëshiruar nga ana e tyre për vijuar/zgjatuar më tej afatin e sekondimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kështu që në këtë pikë, kemi menduar që të paraqesim dy relacione. Relacioni i parë i mbështetur në nenin 53 dhe 54 të ligjit ‘Për statusin’, pra të bëjmë atë procedurën e përgjithshme, të bëjmë thirrjen për të gjithë gjyqtarët, të shpallim garën, të përcaktojmë kriteret, afatet dhe më pas marrim të gjithë kërkesat e kandidatëve gjyqtarë që duhet të shprehin interesin e tyre për t’u përfshirë në garë në lidhje me kërkesën e drejtuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës për punën si sekondar pranë

Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku normalisht është e kuptueshme që nëse do të pranojmë këtë procedurë, atëherë një kandidat potencial do të ishte edhe zoti {...}; dhe për sa kohë Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës e ka shfaqur pëlqimin e tij sepse ka kërkuar specifikisht që në këtë pozicion ata kërkojnë z. {...}, ne kemi bërë edhe versionin e dytë të relacionit, bashkëlidhur edhe projektvendimin e dytë. Relacioni i dytë lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve të komandimit, nëse ka ndonjë rrethanë, kusht apo kriter ndalues që do të privonte mundësinë e kandidimit të z. {...} në këtë skemë të komandimit. Në këtë pikë, ne kemi bërë të gjitha verifikimet që parashikohen në nenin 54 të ligjit “Për statusin”, pra kemi verifikuar afatin e komandimit, informacionin e dokumentacionin që duhet, procedurën e kandidimit; kemi verifikuar në këtë pikë edhe cenimin ose jo funksionalitetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si gjykatë ku z. {...} ka pozicionin e përhershëm të gjyqtarit në këtë gjykatë. Nga të gjitha verifikimet na ka rezultuar që zoti {...} nuk ka asnjë lloj pengese për të vijuar më tej sekondimin e tij pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kështu që në këtë pikë, pra në mënyrë të përmbledhur, ne kemi paraqitur të dy relacionet, bashkëlidhur me dy projektvendimet sepse edhe vetë personalisht kam qenë i dyzuar nëse në këtë rast duhet të pranojmë atë procedurën e zakonshme, pra të shpallim vendin e kërkuar nga sekretariati në këtë rast, në pozicionin e sekondimit, dhe duke hapur garën për të gjithë gjyqtarët, por nga ana tjetër kam menduar se (dhe i mëshoj më shumë versionit të dytë) vetë sekretariati e ka shfaqur vullnetin e tij dhe ata kanë kërkuar që zoti {...} të vazhdojë të ushtrojë funksionet e tij si sekondar në këtë pozicion pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nëse ne do të vijonim vijimin e procedurave sipas kushteve dhe kriterëve që parashikon neni 53 dhe 54 i ligjit, atëherë unë do të mendoja se në këtë rast mund të ndodheshim përpara procedurave me natyrë formale, për sa kohë edhe sekretariati ka shfaqur vullnetin e tij. Por gjithsesi këto janë çështje që unë vetë jua kam parashtruar sepse kam qenë i dyzuar për zgjedhjen e procedurës më të saktë që ne duhet të vendosim në rastin konkret.

Bashkëlidhur të dy relacioneve ne kemi paraqitur edhe projektvendimet përkatëse të cilat për nga struktura e tyre normalisht që ndryshojnë nga njëra-tjetra, pasi

projektvendimi i parë është ai i tipit standard që ne e kemi propozuar edhe në raste të tjera të ngjashme, në rastet kur kemi shpallur vende për të kandiduar kolegët tanë magjistratë në vende të tjera që kanë kërkuar institucionet tona të brendshme. Ndërsa, projektvendimi i dytë i referohet situatë konkrete që unë referova më lart, ku ky projektvendim i përshtatet kërkesës konkrete që ka paraqitur sekretariati i Këshillit të Evropës për zgjatjen e sekondimit (afatin e sekondimit) për z. {...} edhe për një vit tjetër, pra deri më datën 31 dhjetor të vitit 2024.

Me pak fjalë, ky ishte prezantimi i të dy versioneve të relacionit i cili shoqërohet edhe me dy projektvendimet përkatëse.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Klodi ti kë sugjeron?

Klodian Kurushi: Unë sugjeroj versionin e dytë dhe projektvendimin e dytë, për arsye sepse sekretariati e ka bërë përzgjedhjen e tij. Domethënë ai ka kërkuar drejtpërdrejt zyrtarisht me institucionet shqiptare që të zgjatet sekondimi i zotit {...}.

Naureda Llagami: Ok!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim mbi procedurën?

Kalojmë me versionin e dytë që sugjeron edhe kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në votim?

Kalojmë në votim të versionit ku kemi komandim të z. {...} në pozicionin e “këshilltarit juridik” në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e “këshilltarit juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për një afat deri më 31.12.2024.

2. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit, sipas ligjit.

3. Gjatë kohës së komandimit në pozicionin e “këshilltarit juridik”, gjyqtari do të përfitojë pagën, si dhe do t’i paguhet kontributet e detyrueshme mbi të për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe për pension suplementar.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të komanduar z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

5. Ngarkohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 11 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Fatmira Luli.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.

4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

11 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatores znj. Fatmira Luli.

Naureda Llagami: Tani kemi dy aktet, të cilat ne i shtuam sot në rendin e ditës. Së pari, ka të bëjë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmëses ligjore. Shkurtimisht Fatmira, pasi kemi përfunduar procedurën e kualifikimit dhe dje Këshilli hapi vendet dhe i janë propozuar dy vende.

Fatmira Luli: Faleminderit Kryetare!

Dje Këshilli në mbledhje plenare caktoi dy vende për t’ia ofruar ndihmëses ligjore {...}, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Apelit Administrativ. Menjëherë dje ka depozituar kërkesë {...} për zgjedhjen e Gjykatës Administrative të Apelit.

Në këto kushte Këshilli duhet të vendosi pranimin e kërkesës së saj për pranimin

në shërbimin civil të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Struktura e vendimit parashikohet nga pika e parë: Pranimin e kërkesës në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pika dy: Efektet juridike të vendimit, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

Pika tre parashikohet që një kopje e vendimit i njoftohet kandidates, sipas ligjit nr. 115/2016.

Pika katër: E drejta e ankimit kundër vendimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Në fund parashikohet se hyrja është në mënyrë të menjëhershme.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, propozimi për emërimin është, sikurse ka shprehur dëshirën, në Gjykatën Administrative të Apelit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Do ta fillojmë me datën e sotme Fatmira apo ta fillojmë menjëherë, se kemi vënë këtu datën.

Ok, ta kalojmë menjëherë.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, [...].

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, [...].

* * *

(Pika 11 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.12.2023)

Pika 12 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë” ose “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 4/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relator z. Ridvan Hado.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
4. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}” ose “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 4/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relator z. Ridvan Hado.

Naureda Llagami: Kalojmë edhe tek akti tjetër, që ka të bëjë mbi caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}. Lidhur me caktimin e datës do të doja shkurtimisht relatori ta merrte fjalën për të na thënë mbi procedimin dhe propozimin për datën.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}. Kjo kërkesë bazohet në nenin 194 të ligjit 115 “Për organet e qeverisjes” dhe në nenin 138 të ligjit 96 “Për statusin”. Në këtë kërkesë për fillimin e procedimit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës “Shkarkim nga detyra” të magjistratit {...} sipas parashikimeve të nenit 111 të ligjit “Për statusin”.

Nga shorti, me vendimin nr. 710, datë 04.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje. Me faktet dhe rrethanat e pretenduara jeni njohur.

Lidhur me verifikimet e bëra nga ana ime në referim të nenit 31 të rregullores, nëse jemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 139, pra që mbyllet vendimmarrja pa zhvilluar seancë dëgjimore, nuk jemi përpara rasteve të kërkuara nga neni 139. Nuk jemi përpara parashkrimit sipas parashikimit të nenit 117, pasi procedimi disiplinor, hetimi disiplinor ka filluar brenda afatit 5-vjeçar. Gjithashtu nuk rezulton që çështja të ketë qenë objekt i një procedimi tjetër disiplinor që të jetë zgjidhur me vendim të formës së prerë. Po ashtu nuk jemi përpara kërkesave të parashikuara nga neni 134, pika 1, shkronja /ç/ dhe /d/, që referon tek neni 64 “Për statusin” dhe neni 67 (siç janë të gjitha rastet: nuk ka dhënë dorëheqjen magjistrati, nuk është në kushtet e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit, nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, pra që të dali në pension, nuk është shkarkuar nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, nuk vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën për pamundësi fizike dhe mendore).

Në mbledhjen e datës së sotme Komisioni Disiplinor, mbasi dëgjoni relatimin nga ana ime vendosi t’i propozojë mbledhjes caktimin e datës dhe të orës për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Në kushtet sa më sipër meqenëse s’ndodhemi në asnjë nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore duke pasur parasysh që kjo

çështje është regjistruar në datën 30.11.2023 për të respektuar afatin 1-mujor dhe gjithashtu edhe afatin e njoftimit 15-ditor. Pra sot është data 7, i propozoj mbledhjes datën nga 25 e në vijim. Data 26, ora 11:00.

Naureda Llagami: Atëherë, caktimi i datës është 26, ora 11:00. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e datës 26, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Atëherë, me kaq po mbyllim mbledhjen për shqyrtimin e çështjeve që i kemi publike, për të vijuar më pas me shqyrtimin e 3 çështjeve të tjera.

* * *

(Pika 12 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor